

Nr. 7 Regj.

Durrës, më 05. 01. 2026

Lënda: Në përgjigje të kërkesës suaj.

Emër MBIEMËR*Adresa*

Në kuadër të implementimit të *Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”* (i ndryshime), si dhe në referencë të kërkesës suaj, datë 30.12.2025, me objekt “*Kërkesë për informacion mbi ecurinë e punimeve në linjën hekurudhore Durrës- Tiranë- Rinas*” e regjistruar në regjistrin e “*Kërkesë/Ankesë/Përgjigje*” në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar me numrin rendor 7 (shtatë), ju informojmë për si vijon:

1. Sa përqind e punimeve të projektit “Tiranë - Durrës - Rinas” është realizuar deri në momentin aktual?

Përsa i përket Kontratës së parë të Projektit Hekurudhor ‘Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës-Tiranë (PTT) dhe ndërtimi i Linjës së re hekurudhore në drejtim të Areoportit Ndërkombëtar të Rinasit (TIA) ka arritur në **masën 88% të punimeve** ndërtimore civile. Ndërsa Kontrata e dytë, “Ndërtimi i godinave të reja të stacioneve hekurudhore” përbën një kontratë tjetër, e cila ka nisur zbatimin në muajin maj 2025 dhe aktualisht ka arritur në rreth **30% të realizimit**. Gjithashtu, parashikohet lidhja e kontratës së tretë ndërtimore, për elektrifikimin e linjës, brenda tremujorit të parë të vitit 2026.

2. Cilat janë segmentet ku punimet kanë përfunduar dhe cilat janë ende në proces ndërtimi?

Punimet civile janë 100% të përfunduara në të gjitha segmentet e linjës. Aktualisht mbeten vetëm për t’u realizuar instalimi i pajisjeve të sinjalizimit dhe telekomunikacionit në stacionet hekurudhore, të cilat lidhen drejtpërdrejt me përfundimin e ndërtimit të godinave të stacioneve hekurudhore, pasi këto pajisje instalohen brenda tyre.

3. Cilat kompani janë kontraktuar për fazat e ndërtimit dhe mirëmbajtjes, dhe cila është vlera përkatëse e kontratave?

Për fazat e ndërtimit janë kontraktuar këto subjekte:

– Shoqëria **I.N.C. S.p.A.**, me kontratë në vlerën rreth **98.69 milionë euro**, për punimet civile të linjës hekurudhore;

– Shoqëria **STRABAG sh.p.k.**, për kontratën e ndërtimit të godinave të stacioneve hekurudhore dhe sistemimin e shesheve të jashtme, me vlerë rreth **10.5 milionë euro**.

4. A ka pasur vonesa, penalitete ose shtesa financiare gjatë zbatimit të kontratave?

Gjatë zbatimit të kontratave janë evidentuar vonesa në kohë dhe shtesa financiare. Këto kanë ardhur si rezultat i zbatimit të detyrimeve kontraktuale për rregullimin e çmimeve të materialeve ndërtimore për shkak të rritjes së çmimeve dhe renis së Euros gati 30% (aplikuar kontraktualisht sipas klauzoles 13.8 “price adjustment”), si dhe përfshirjes së një komponenti shtesë, konkretisht ndërtimi i godinave të stacioneve hekurudhore, të cilat nuk ishin pjesë e kontratës fillestare. Për këtë qëllim është siguruar financim shtesë nga ana e BERZH. Gjithashtu janë hasur në mënyre të vazhdueshme probleme sociale dhe të lidhura drejtpërsëdrejti me akseset e bizneseve, banoreve apo dhe qendrave të ndryshme zhvillimore përgjatë të gjithë segmentit nga Durrësi, në Tiranë e deri në Aeroportin e Rinasit. Këto kanë shkaktuar vonesa si edhe nevoja të vazhdueshme për shpronësime.

5. Cilat janë masat e marra për sigurinë e punonjësve dhe komuniteteve përreth gjatë fazës së ndërtimit?

Masat për sigurinë dhe shëndetin në punë janë zbatuar në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi, me qëllim garantimin e sigurisë së punonjësve dhe mbrojtjen e komuniteteve përreth zonave të ndërtimit. Duhet theksuar që ky projekt është një nga projektet e vetme ku standartet janë shumë të larta dhe mbikqyrja dhe monitorimi është tepër i lartë nga Hekurudha, BERZH dhe Supervizori i Punimeve, si edhe aktor të tretë konsulencash ndërkombëtare.

6. A janë kryer auditime ose monitorime të pavarura për cilësinë e punimeve? Nëse po, ju lutem të vihen në dispozicion raportet përkatëse.

Deri në këtë fazë, nuk janë kryer auditime apo monitorime të pavarura për cilësinë e punimeve, duke qenë se kontratat përkatëse janë ende në proces zbatimi dhe janë në përputhje të plotë me aktet kontraktuale. Në përfundim të realizimit të punimeve do të kryhen testet dhe komisionimet përkatëse si edhe certifikimi i linjës nga enti i certifikuar Agjencia Hekurudhore Evropiane (ERA-European Railway Agency)

7. Cilat janë parashikimet për fazën e operimit të linjës - përfshirë numrin e trenave që do të vihen në qarkullim, shpeshësinë e udhëtimeve dhe parashikimet për tarifën e udhëtimit?

Për fazën e operimit të linjës, parashikimet për numrin e trenave, shpeshhtësinë e udhëtimeve dhe tarifat do të përcaktohen përfundimisht pas përfundimit të fazës së ndërtimit dhe testimit teknik të linjës. Besojme se kjo do të ndidhe brenda vitit 2026.

8. A janë përfunduar sistemet e sinjalizimit dhe të elektrifikimit përgjatë linjës, dhe cilat standarde teknike po përdoren për to?

Sistemet e sinjalizimit dhe telekomunikacionit nuk janë përfunduar ende, por janë në proces zbatimi dhe pritet të përfundojnë brenda Qershor 2026. Elektrifikimi i linjës do të realizohet përmes një kontrate të veçantë, e cila pritet të lidhet brenda tremujorit të parë të vitit 2026. Aktualisht jemi në proces tenderimi ndërkombëtar nëpërmjet BERZH. Standardet teknike përkatëse do të përcaktohen në dokumentacionin kontraktual që disponohet në secilën kontratë përkatëse.

9. A parashikohet eliminimi gradual i kalimeve në nivel pas fillimit të funksionimit të linjës, dhe nëse po, sipas cilit plan kohe?

Kalesat në nivel nuk parashikohet të eliminohen pasi janë projektuar dhe ndërtuar në përputhje me parashikimet e Kodit Hekurudhor në fuqi. Megjithatë nga 34 kalesa në nivel që ishin deri në vitin 2021 (përpara fillimit të kontrates) janë optimizuar dhe janë 17 kalesa në nivel në të gjithë segmentin prej 39km. Të gjitha kalesat janë të automatizuara, moderne dhe me nivelin më të lartë të sinjalizimit dhe sigurisë (quajtur “Interlocking System SIL-4”).

**Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e informimit” dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Me konsideratë!

KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT

Domeniko SINJARI